



Datë: 21.08.2025
Numër Protokolli: 5383/2025

A.nr.1145/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1145/2025, të datës 16.06.2025, të parashtruar nga ankuesja V.M, nga Prishtina, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, s i dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1145/2025, e datës 16.06.2025, e parashtruar nga ankuesja V.M.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër reference RN00017457, i datës 11.06.2025 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financa, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 16.06.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1145/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00017457 për pozitën Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave,

me datën 20.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 02.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 16.07.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4767/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.1145/2025 të datës 16.07.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4031/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 16.06.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4767/2025 i datës 16.07.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Konkurs i datës 25.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë 20.06.2025; Përgjigje në ankesë e datës 02.07.2025; Njoftimin e datës 11.06.2025 për kandidatin fitues; Formulari i renditjes përfundimtare i datës 11.06.2025; Vendimin e datës 02.05.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së me akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Aplikacionin e kandidates së suksesshme e datës 23.04.2025; Diplomë e datës 21.09.2020 Nr.7072; Vërtetimin e datës 24.04.2025 i Njesisë së Burime Njerëzore e Kuvendit të Kosovës; Akt Emërimit e datës 01.08.2022; Aplikacionin e datës 18.04.2025 të kandidates V.R me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomë e datës 18.07.2014; Vendimin e datës 20.07.2018 e Nënkyetarit të Kosovës; Vendimin e datës 12.08.2018 e Nënkyetarit të Kosovës; Aplikacionin e datës 02.04.2025 të ankueses me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 06.10.2021 Nr.7593; Kontratë pune e datës 06.07.2022; Pasqyra e llogarisë së trustit; Kopje e letërnjoftimit të ankueses; Aplikacionin e kandidatit Xh. E me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomë e datës 30.05.2006 Nr.680; Referencë e datës 16.12.2014; Vërtetim e datës 25.06.2018; Vërtetimin e datës 14.06.2018; Referencën e datës 03.03.2014; Kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e datës 18.04.2025 të kandidates F.M me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomën e datës 04.09.1997 Nr.309; Aktvendimin e datës 31.01.2006; Kontratë pune e datës 10.01.2024; Kontratë pune e datës 21.10.2024; Kontratë pune/Eulex e datës 14.06.2010; Kontratë Pune/Unmik e datës 01.04.2008; Vërtetimin e datës 28.03.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të eses nga kandidatët e komisionit; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatët në intervistë me gojë të datës 11.06.2025; Testin me shkrim të ankueses dhe kandidates së suksesshme; E-mailin e datës 25.07.2025 dërguar nga K.D për Këshillin; Vendimin e datës 21.03.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, më datë 25.03.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017457, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar i Lartë Ekzekutiv-Profesional 2” në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.03.2025 deri më 24.04.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Tutje, ankuesja i është nënshtruar testimit me shkrim, ndërsa nga Njësia e Burimeve Njerëzore, është njoftuar se ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 49.4 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullore (QRK) Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: ”2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.”, ndërsa sipas Njoftimit të datës 11.06.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së intervistimit me gojë, rezulton se kandidati që ka marrë më së shumti pikë, është E.K me gjithsejtë 96.2 pikë, prej të cilave 67.6 pikë nga testi me shkrim, e cili rezulton të jetë edhe kandidatja e suksesshme në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Njoftimit të datës 11.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB-së lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se të njëjtës i është bërë e pa drejtë, me dyshimin se për shkak të lëshimeve teknike mund të jetë bërë gabimi në përllogaritjen e vlerësimit të përgjithshëm të pikëve, ngase vetëm për një diferencë të vogël prej 0.6 pikësh nuk e kam kaluara testin me shkrim, me kërkesën për rivlerësimin e testit me shkrim për shkak të së drejtës në transparencë.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, nga analizimi i testit me shkrim të ankueses konstatoi se e njëjta nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 49.4 pikë (prej të cilave 44 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 5.4 pikë nga eseja), ndërsa kandidati i suksesshëm nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 67.6 pikë (prej të cilave 50 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 17.6 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullores (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil ku përcaktohet: “Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit”, si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “6. Testi me shkrim përmban gjithsejtë njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi”, dhe konstatoi se sistemi që funksionon në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimi e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas testit me shkrim të datës 04.06.2025 me kod

aplikimi CN7405-ankuesja për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsejtë (5.4) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: “9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. **Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim**”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankueses nuk janë të bazuara, ngase Komisioni i Pranimi asnjërin nga kandidatët nuk e ka vlerësuar me 20 pikë, aq sa është edhe maksimumi i vlerësimit të eses, respektivisht ankuesen e ka vlerësuar me gjithsejtë 5.6 pikë, kurse kandidatin e suksesshëm E.K e ka vlerësuar në ese me 17.6 pikë, ashtu që Kolegji i Këshillit nuk gjeti se në këtë fazë ka pasur shkelje sikurse ankuesja pretendon, për rrjedhojë ankuesja nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye e njëjta është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në esenë me shkrim, ngase eseja me shkrim ka qenë: “**Përshkruani disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës në të cilën keni aplikuar**”, ndërsa ankuesja në përgjigjen e saj ka folur për shkathësitë që duhet të ketë kandidati për pozitën përkatëse të rekrutimit, pra në parim nuk ka folur për detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës në të cilën ka aplikuar, gjegjësisht detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës apo thënë ndryshe përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozitën përkatëse ka qenë i përcaktuar me Pikën 1 të konkursit të datës 25.03.2025 në të cilën edhe ankuesja ka aplikuar, si në vijim: “*Është përgjegjës për organizimin dhe përcjelljen e funksionimit efikas të punës së Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm; Kujdeset dhe është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave ndihmëse, shërbimeve dhe punëve profesionale në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm; Është përgjegjës dhe kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore dhe procedurave përkatëse në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm; Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi; Përgatit raporte dhe harton shkresa të ndryshme Koordinon punët me qëllim të shpërndarjes racionale dhe proporcionale të punëve në Departamentet dhe njësite tjera të Ministrisë; Bashkëpunon me departamentet e Ministrisë sipas udhëzimeve të SP, lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të punës brenda afateve kohore; Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi*”, ndërsa kandidatja e suksesshme në përgjigjet e saja të dhëna në testin me shkrim të datës 04.06.2025 iu është referuar disa prej detyrave dhe përgjegjësi të pozitës përkatëse sikurse është kërkuar në testin me shkrim.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të pabazuara dhe për rrjedhojë procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara ligjore të ligjit material, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që refuzoi ankesën e ankueses, ndërsa la në fuqi aktin e kontestuar pasi që i njëjti është nxjerrë duke u bazuar në ligjin material dhe në dispozitat e përcaktuara si në nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132

paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1145/2025, datë 11/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.M;
- Ministria e Punëve të Brendshme (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.